



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo - Republika Kosova
Qeveria- Government -Vlada

**PROJEKTLIGJI PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SHETËRORE
DHE AGJENCIVE TË PAVARURA¹**

**DRAFT LAW ON ORGANIZATION AND FUNCTIONING OF STATE ADMINISTRATION AND
INDEPENDENT AGENCIES²**

**NACRT ZAKON O ORGANIZACIJI I FUNKCIONISANJU DRŽAVNE UPRAVE I NEZAVISNIH
AGENCIJA³**

¹ Projektligji për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, është miratuar në mbledhjen e 63- të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 10/63 të datës 03.09.2018.

² Draft Law on Organization and Functioning of State Administration and Independent Agencies, was approved in the 63- meeting of the Government of Republic of Kosovo with the decision No: 10/63 date: 03.09.2018.

³ Nacrt Zakon o Organizaciji i Funkcionisanju Državne Uprave i Nezavisnih Agencija, usvojenje na 63- sednici Vlade Republike Kosova, odlukom br: 10/63 datum: 03.09.2018.

| | | |
|--|--|---|
| <p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE TË AGJENCIVE TË PAVARURA</p> <p>KAPITULLI I</p> <p>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi</p> <p>1.Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës.</p> <p>2.Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër koherent ligjor për themelimin, organizimin, funksionimin, përgjegjshmërinë dhe performancën e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.</p> | <p>Assembly of Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p>LAW ON ORGANIZATION AND FUNCTIONING OF STATE ADMINISTRATION AND INDEPENDENT AGENCIES</p> <p>CHAPTER I</p> <p>GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Scope and Purpose</p> <p>1 This Law defines rules for organization and functioning of institutions of state administration and independent agencies established by the Assembly of Kosovo.</p> <p>2. The purpose of this Law is to provide a coherent legal framework for establishment, organisation, functioning, responsibility and performance of institutions of state administration and independent agencies.</p> | <p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Shodno članu 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKON O ORGANIZACIJI I FUNKCIONISANJU DRŽAVNE UPRAVE I NEZAVISNIH AGENCIJA</p> <p>POGLAVLJE I</p> <p>OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Svrha i oblast delovanja</p> <p>1. Ovaj zakon utvrđuje pravila za organizaciju i funkcionisanje institucija državne uprave i nezavisnih agencija koje je osnovala Skupština Kosova.</p> <p>2. Svrha ovog zakona je stvaranje koherentnog pravnog okvira za uspostavljanje, upravljanje, dobro funkcionisanje, odgovornost i učinak institucija državne uprave i nezavisnih agencija.</p> |
|--|--|---|

| <p style="text-align: center;">Neni 2 Përkufizimet</p> | <p style="text-align: center;">Article 2 Definitions</p> | <p style="text-align: center;">Član 2 Definicije</p> |
|---|--|--|
| <p>1. Fjalët apo shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. funksion i hartimit të politikave - është përgatitja e politikave publike, hartimin i akteve ligjore, miratimi i akteve nënligjore dhe përcaktimi i standardeve të detyrueshme.</p> <p>1.2. funksioni i dhënies së shërbimeve publike - është veprimtaria e ofrimit të shërbimeve apo e prodhimit të të mirave materiale, të përcaktuara me ligj si shërbime publike, për të cilat Qeveria apo një komunë ka detyrimin ligjor t'i ofrojë apo të sigurojë për qytetarët e Republikës së Kosovës, siç janë shërbimi shëndetësor publik, arsimit publik, furnizimi me ujë, pastrimi i ujërave të ndotura, mbledhja e mbeturinave apo shërbime të tjera në fushën e kulturës, rinisë, artit, përkujdesjes shoqërore, etj.</p> <p>1.3. funksion i zbatimit të politikave - është zbatimi i legjislacionit, politikave dhe dhënia e shërbimeve publike.</p> <p>1.4. funksion i brendshëm mbështetës - përfshin menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin financiar,</p> | <p>1. The terms of expressions used in this Law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. policy development function - is preparation of public policies, drafting legal acts, adoption of bylaws and setting mandatory standards.</p> <p>1.2. public service delivery function - is the activity of service delivery or production of material goods as defined by law as public services, for which the Government or a municipality is legally required to deliver or provide for citizens of Republic of Kosovo, such as public health care service, public education, water supply, wastewater treatment, waste collection or other services in the area of culture, youth, art, social care, etc.</p> <p>1.3. policy implementation function - is implementation of legislation, policies and public service delivery.</p> <p>1.4. internal support function - includes human resource management, financial management, general management (of</p> | <p>1. Pojmovi ili izrazi korišćeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. funkcija izrade politika - priprema javnih politika, pisanje pravnih i podzakonskih akata i definisanje obaveznih standarda;</p> <p>1.2. funkcija pružanja javnih usluga - delatnost pružanja usluga ili proizvodnje materijalnih dobara, definisana zakonom kao javna služba, koje su Vlada ili opštine zakonom dužne da pruže ili obezbede državljanima Republike Kosovo, kao što su javne zdravstvene usluge, obrazovanje, vodosnabdevanje, prečišćavanje otpadnih voda, sakupljanje otpada ili druge usluge iz oblasti kulture, omladine, umetnosti, socijalne zaštite itd;</p> <p>1.3. funkcija sprovođenja politika - sprovođenje zakonodavstva, politika i pružanja javnih usluga;</p> <p>1.4. funkcija interne podrške - delatnosti koje uključuju upravljanje ljudskim resursima, finansijama, opšte</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>menaxhimin e përgjithshëm (të pronave, të pasurisë, teknologjisë informative, logjistikës), auditim, si dhe të funksioneve të tjera të ngjashme mbështetëse, që bëjnë të mundur funksionimin normal të institucioneve.</p> <p>1.5. funksion administrativ - janë funksionet sipas nënparagrafëve 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të paragrafit 1 të këtij neni së bashku, si dhe çdo funksion tjetër administrativ në zbatimin e procedurave administrative.</p> <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli 1</u> <u>Parimet</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Parimi i ligjshmërisë</p> <p>Administrata publike ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe legjislacionit tjetër të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Parimi i profesionalizimit dhe neutralitetit politik</p> <p>Administrata publike i shërben interesit publik dhe qytetarëve me profesionalizëm dhe neutralitet politik në vendimmarrje.</p> | <p>properties, assets, information technology, logistics), audit, and other similar support functions the enable normal functioning of institutions.</p> <p>1.5. administrative function - are functions under sub-paragraphs 1.1, 1.2, 1.3 and 1.4 of paragraph 1 of this article altogether, as well as any other administrative function in the implementation of administrative procedures.</p> <p style="text-align: center;"><u>Sub-chapter 1</u> <u>Principles</u></p> <p style="text-align: center;">Article 3 Principle of lawfulness</p> <p>Public administration shall perform its activities on the basis of Constitution, law and other applicable legislation in the Republic of Kosov</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Principle of professionalism and political neutrality</p> <p>Public administration serves to public interest and citizens with professionalism and political neutrality in decision making.</p> | <p>upravljanje (imovinom, bogatstvima, informacionom tehnologijom i logistikom), reviziju i druge slične prateće funkcije koje omogućavaju normalno funkcionisanje institucija.</p> <p>1.5. upravne funkcije - funkcije iz podstavova 1.1, 1.2, 1.3 i 1.4 stava 1 ovog člana zajedno, kao i svaka druga upravna funkcija u sprovođenju administrativnih postupaka.</p> <p style="text-align: center;"><u>Potpoglavlje 1</u> <u>Načela</u></p> <p style="text-align: center;">Član 3 Načelo zakonitosti</p> <p>Javna uprava vrši svoju delatnost na osnovu Ustava, zakona i drugih propisa važećih u Republici Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Načelo profesionalizma i političke neutralnosti</p> <p>Javna uprava služi javnom interesu i građanima profesionalno i uz političku neutralnost u procesu donošenja odluka.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 5 Parimi i transparencës</p> <p>Administrata publike ushtron veprimtarinë në mënyrë transparente dhe duke informuar publikun për veprimtarinë e saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Parimi i bashkëpunimit ndërinstitucional</p> <p>Institucionet e administratës publike shkëmbejnë informacion dhe bashkëpunojnë në ushtrimin e funksioneve të tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Parimi i mundësive të barabarta</p> <p>Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, si dhe pjesëtarët e dy gjinive, kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe përfaqësim në institucionet e administratës publike në nivelin qendror dhe lokal, në pajtim me ligjin.</p> <p>KAPITULLI II</p> <p>ADMINISTRATA SHETËRORE</p> <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli 1</u> <u>Dispozita të përgjithshme për administratën shtetërore</u></p> | <p style="text-align: center;">Article 5 Principle of transparency</p> <p>Public administration shall perform activity in a transparent way and informing the public for its activity.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Principle of interinstitutional cooperation</p> <p>Institutions of public administration exchange information and cooperate in performing their functions.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Principle of equal opportunities</p> <p>Communities and their members, disabled persons and members of both genders have equal opportunities to participate and be represented in institutions of public administration at the central and local level in accordance with the law.</p> <p>CHAPTER II</p> <p>STATE ADMINISTRATION</p> <p style="text-align: center;"><u>Sub-chapter 1</u> <u>General provisions on the state administration</u></p> | <p style="text-align: center;">Član 5 Načelo transparentnosti</p> <p>Javna uprava vrši delatnost na transparentan način i informiše javnost o svojoj delatnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Načelo međuinstitucionalne saradnje</p> <p>Institucije javne uprave razmenjuju informacije i saraduju u vršenju svojih funkcija.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Načelo jednakih mogućnosti</p> <p>Zajednice i pripadnici zajednicama, lica sa invaliditetom i pripadnici oba pola imaju jednake mogućnosti učešća i zastupljenosti u institucijama javne uprave na centralnom i opštinskom nivou, u skladu sa zakonom.</p> <p>POGLAVLJE II</p> <p>DRŽAVNA UPRAVA</p> <p style="text-align: center;"><u>Potpoglavlje 1</u> <u>Opšte odredbe o državnoj upravi</u></p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 8 Administrata shtetërore</p> <p>1.Administrata shtetërore, është aparati organizativ dhe profesional i Qeverisë, që i shërben interesit publik nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave.</p> <p>2.Administrata shtetërore përbëhet nga struktura hierarkie të organizuara, nën drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e Qeverisë.</p> <p>3.Administrata shtetërore ka personalitet juridik unik.</p> | <p style="text-align: center;">Article 8 State Administration</p> <p>1. State administration is the organizational and professional apparatus of Government, which serves public interest by drafting and implementing policies.</p> <p>2. State administration consists of organized hierarchical structures under the leadership, control and supervision of Government.</p> <p>3. State administration has its unique legal personality.</p> | <p style="text-align: center;">Član 8 Državna uprava</p> <p>1.Državna uprava je organizacioni i profesionalni aparat vlade koji služi javnom interesu kroz izradu i sprovođenje politika.</p> <p>2.Državna uprava se sastoji od hijerarhijski organizovanih struktura pod rukovodstvom, kontrolom i nadzorom Vlade.</p> <p>3. Državna uprava ima svojstvo jedinstvenog pravnog lica.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 9 Organizimi i administratës shtetërore</p> <p>1. Administrata shtetërore përbëhet nga Zyra e Kryeministrit, sistemet ministrore dhe agjencitë rregullatore.</p> <p>2. Sistemi ministror përbëhet nga:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. ministria;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. agjencia ekzekutive, dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3.administratat e shërbimeve publike.</p> <p>3. Përjashtimisht, në varësinë e Kryeministrit mund të themelohen agjenci ekzekutive për</p> | <p style="text-align: center;">Article 9 Organization of State Administration</p> <p>1. The State Administration consist of the Office of Prime Minister, ministerial systems and regulatory agencies.</p> <p>2. A ministerial system consists of:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. ministry;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. executive agencies, and</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3 public services' administrations.</p> <p>3. Notwithstanding the above, executive agencies may be established under the the</p> | <p style="text-align: center;">Član 9 Organizovanje državne uprave</p> <p>1. Državnu upravu čine: Kancelarija premijera, ministarski sistemi i regulatorne agencije.</p> <p>2. Ministarski sistem se sastoji od:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. ministarstava,</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. izvršnih agencija i</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. uprava javnih službi.</p> <p>3. Izuzetno, izvršne agencije mogu biti uspostavljene pod nadležnošću Kancelarije</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>mbulimin e funksioneve të koordinimit qeveritar apo të natyrës horizontale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Përgjegjësia për administratën shtetërore</p> <p>1. Ministri është politikisht përgjegjës para Qeverisë dhe Kuvendit për veprimtarinë e të gjithë sistemit ministror në fushën e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuar me legjislacionin përkatës.</p> <p>2. Ministri (në vijim : ministri përgjegjës) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e sistemit ministror dhe mbikëqyr veprimtarinë e agjencive rregullatore në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, në pajtim me këtë ligj.</p> <p>3. Funksionimi i sistemit të përgjegjësisë të ministrit për performancën e sistemit ministror përcaktohet në pajtim me legjislacionin për funksionimin e Qeverisë.</p> <p>4. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen edhe për Kryeministrin lidhur me agjencitë ekzekutive në varësi të tij.</p> <p>5. Fusha e përgjegjësisë shtetërore për çdo ministri, përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.</p> | <p>Prime Minister to perform government coordination functions or functions of horizontal nature.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Responsibility for the State Administration</p> <p>1 Minister shall be politically accountable to the Government and Assembly for the activity of the entire ministerial system in the area of state responsibility provided by the relevant legislation.</p> <p>2. The Minister (hereinafter: “responsible minister”) shall lead and control activities of a ministerial system and shall supervise the activity of regulatory agencies in the relevant area of state responsibility, in accordance with this Law.</p> <p>3 Functioning of the system of minister’s responsibility for the performance of ministerial system is provided in accordance with legislation on the functioning of the Government.</p> <p>4. Provisions of paragraphs 1, 2 and 3 of this Article shall also apply to the Prime Minister in relation to independent agencies under its subordination.</p> <p>5. The area of state responsibility for each ministry is defined in a bylaw adopted by the Government.</p> | <p>premierja radi obavljanja koordinacionih funkcija vlade ili funkcija horizontalne prirode..</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Odgovornost za državnu upravu</p> <p>1. Ministar je politički odgovoran Vladi i Skupštini za delovanje čitavog ministarskog sistema u oblasti državne odgovornosti, kako je definisano relevantnim zakonodavstvom.</p> <p>2. Ministar (u daljem tekstu: "nadležni ministar") rukovodi i kontroliše delatnostima ministarskog sistema i nadzire aktivnosti regulatornih agencija u relevantnoj oblasti državne odgovornosti, u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>3. Funkcionisanje sistema odgovornosti ministra za učinak ministarskog sistema se utvrđuje u skladu sa zakonodavstvom koje određuje funkcionisanje Vlade.</p> <p>4. Odredbe stavova 1, 2. i 3. ovog člana se primenjuju i na premijera u odnosu na njemu podređene izvršne agencije.</p> <p>5. Oblast državne odgovornosti za svako ministarstvo definisana je podzakonskim aktom koji usvaja Vlada.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli 2</u> <u>Tipologjia dhe organizimi i sistemit</u> <u>ministror</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Ministria</p> <p>1. Ministria është përgjegjëse për hartimin e politikave publike në fushën përkatëse të përgjegjësisë.</p> <p>2. Ministria është përgjegjëse për të gjitha funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë, përveç nëse nuk u janë deleguar institucioneve të tjera të administratës shtetërore sipas ligjit.</p> <p>3. Ministria është gjithashtu përgjegjëse për drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë.</p> <p>4. Organizimi i ministrisë përfshin ministrinë dhe degët e saj në territor (në vijim: degët lokale), nëse ka të tilla.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Agjencia Ekzekutive</p> <p>1. Agjencia Ekzekutive themelohet për të kryer funksionet administrative brenda</p> | <p style="text-align: center;"><u>Sub-Chapter 2</u> <u>Typology and organization of ministerial</u> <u>system</u></p> <p style="text-align: center;">Article 11 Ministry</p> <p>1 The Ministry is mainly responsible for developing public policies in the respective area of responsibility.</p> <p>2. Ministry shall be responsible for all administrative functions in respective area of state responsibility, unless delegated by law to other institutions of state administration.</p> <p>3 A ministry shall also be responsible for leading, coordination, control and supervision of the whole ministerial system within the respective area of responsibility.</p> <p>4 Organization of ministry includes the ministerial apparatus and its territorial branches (hereinafter “local branches”), if any.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Executive Agency</p> <p>1 Executive Agency is established to perform the following administrative functions within</p> | <p style="text-align: center;"><u>Potpoglavlje 2</u> <u>Tipologija i organizacija ministarskog</u> <u>sistema</u></p> <p style="text-align: center;">Član 11 Ministarstvo</p> <p>1. Ministarstvo je odgovorno za izradu javnih politika u relevantnoj oblasti odgovornosti.</p> <p>2. Ministarstvo je nadležno za sve upravne funkcije u odgovarajućoj oblasti odgovornosti, osim ukoliko iste nisu prenete na druge institucije državne uprave u skladu sa zakonom.</p> <p>3. Ministarstvo je, takođe, odgovorno za usmeravanje, koordinaciju, kontrolu i nadzor celokupnog ministarskog sistema u okviru odgovarajuće oblasti odgovornosti.</p> <p>4. Organizacija ministarstva uključuje ministarstvo i njegove lokalne ogranke (u daljem tekstu: "lokalni ogranci"), ukoliko postoje.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Izvršna agencija</p> <p>1. Izvršna agencija se osniva za obavljanje sledećih upravnih funkcija u okviru državne</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie apo Zyrës së Kryeministrit, si në vijim:</p> <p>1.1. Zbatimin e ligjit, duke zgjidhur çështje individuale dhe duke kryer veprime administrative sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;</p> <p>1.2. mbledhjen e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore, kontributeve apo detyrimeve të tjera dhe menaxhimin e tyre për qëllimin për të cilin janë krijuar;</p> <p>1.3. mbrojtjen e sigurisë publike nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve policore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike dhe kryerjen e inspektimeve;</p> <p>1.4. mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit për Qeverinë;</p> <p>1.5.ushttrimin e përbashkët të funksioneve të brendshme mbështetëse.</p> <p>2. Agjencia Ekzekutive themelohet me ligj.</p> <p>3. Organizimi i Agjencisë Ekzekutive përfshin strukturën qendrore të institucionit, si dhe degët lokale, nëse ka të tilla.</p> | <p>the scope of state responsibility of a ministry or Office of the Prime Minister:</p> <p>1.1.implementation of the law by resolving individual issues and performing administrative actions in accordance with the law on general administrative procedure;</p> <p>1.2. collecting taxes, fees, customs duties, contributions or other liabilities and managing them for the purpose they were generated;</p> <p>1.3. protection of public security by exercising police authorizations, issuing permits, licenses, authorizations and approvals for specific economic activities and conducting inspections;</p> <p>1.4. collection, aggregation, production and storing data and information for the Government;</p> <p>1.5. joint exercising of internal support functions.</p> <p>2. Executive Agency is established by law.</p> <p>3. Organization of Executive Agency includes central institutional structure, and local branches, if any.</p> | <p>odgovornosti ministarstva ili Kancelarije premijera:</p> <p>1.1. sprovođenje zakona rešavanjem individualnih pitanja i vršenje upravnih radnji u skladu sa Zakonom o opštem upravnom postupku;</p> <p>1.2.prikupljanje poreza, carinskih dažbina ili drugih doprinosa i upravljanje njima u svrhe za koje su uspostavljeni;</p> <p>1.3. zaštita javne bezbednosti kroz izvršavanje policijskih ovlašćenja, izdavanje dozvola, licenci, ovlašćenja i odobrenja za određene privredne delatnosti i vršenje inspekcija;</p> <p>1.4. prikupljanje, sabiranje, proizvodnju i čuvanje podataka i informacija za Vladu;</p> <p>1.5. zajedničko izvršavanje funkcija unutrašnje podrške.</p> <p>2. Izvršna agencija se osniva zakonom.</p> <p>3. Organizacija izvršne agencije uključuje centralnu institucionalnu strukturu, kao i lokalne ogranke, ukoliko postoje.</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 13 Administratat e shërbimeve publike</p> <p>1. Administratat e shërbimeve publike janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve drejtpërdrejt për qytetarët në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, në pajtim me ligjin.</p> <p>2. Administrata e Shërbimit Publik organizohet si një njësi e Shërbimit Publik apo si një institucion i Shërbimit Publik.</p> <p>3. Njësia e Shërbimit Publik apo institucioni i Shërbimit Publik themelohet, organizohet, funksionon dhe shuhet sipas ligjeve të veçanta sektoriale, që rregullojnë atë shërbim publik.</p> <p>4. Veprimtaria e njësisë së Shërbimit Publik drejtohet dhe bashkërendohet nga ministria apo një agjenci ekzekutive përgjegjëse, drejtpërdrejt apo nëpërmjet degëve të tyre lokale.</p> | <p style="text-align: center;">Article 13 Public services' administrations.</p> <p>1. Public service administrations are responsible to provide to citizens direct public services under the competence of the Government of Kosovo in accordance with the law.</p> <p>2. Public service administration is organized as a public service unit or as a public service institution.</p> <p>3. A public service unit or public service institution is established, organized, functions and is terminated according to special sector laws regulating such public service.</p> <p>4. The activity of the public service unit is directed and coordinated by the ministry or a responsible executive agency, directly or through their respective local branches.</p> | <p style="text-align: center;">Član 13 Uprave javnih službi</p> <p>1. Uprave javnih službi su odgovorne za pružanje direktnih javnih usluga koje su pod nadležnošću Vlade Kosova građanima, kao što je propisano zakonom.</p> <p>2. Uprava javnih službi organizovana je kao jedinica javne službe ili kao institucija javne službe.</p> <p>3. Jedinica javne službe i institucija javne službe se osniva, organizuje, funkcioniše i gasi u skladu propisima posebnih sektorskih zakona koji regulišu tu javnu službu.</p> <p>4. Delatnost jedinice javne službe vodi i koordinira ministarstvo ili odgovorna izvršna agencija, direktno ili preko svojih lokalnih ogranaka.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 14 Agjencia Rregullatore</p> <p>1. Agjencia Rregullatore, themelohet për të kryer funksione administrative, që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës</p> | <p style="text-align: center;">Article 14 Regulatory Agency</p> <p>1. Regulatory Agency is established to perform administrative functions pertaining to the regulation and oversight of activities of specific market operators in order to protect consumers and ensure free competition.</p> | <p style="text-align: center;">Član 14 Regulatorna agencija</p> <p>1. Regulatorna agencija se osniva radi izvršavanja upravnih funkcija koje se odnose na regulisanje i nadzor nad aktivnostima određenih tržišnih operatora u cilju zaštite potrošača i obezbeđivanja slobodne konkurencije.</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>së lirë.</p> <p>2. Agjencia Rregullatore themelohet me ligj.</p> <p>3. Paragrafët 3 dhe 4 të nenit 12 të këtij ligji zbatohen edhe për Agjencinë Rregullatore.</p> <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli 3</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Organizimi i brendshëm i administratës shtetërore</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Organizimi i brendshëm i ministrisë</p> <p>1. Ministria drejtohet nga ministri dhe organizohet në këto nivele hierarkike:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. sekretari i përgjithshëm;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. departamentet, dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. divizionet.</p> <p>2. Njësitë administrative, të parashikuara në nënparagrafët 1.2. dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, organizohen në madhësi të përshtatshme në bazë të funksionit dhe kompleksit përkatës. Si rregull, çdo nëpunës civil apo nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës është pjesë e një njësie administrative.</p> | <p>2. Executive Agency is established by law.</p> <p>3. Paragraphs 3 to 4 or article 12 of this Law shall apply also for Regulatory Agency.</p> <p style="text-align: center;"><u>Sub-Chapter 3</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Internal organization of state administration</u></p> <p style="text-align: center;">Article 15 Internal organization of ministry</p> <p>1 Ministry is led by the minister and is organized in the following hierarchical levels:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 General secretary</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. departments, and</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. divisions.</p> <p>2. Administrative units, provided for in subparagraphs 1.2 and 1.3 of paragraph 1 of this article shall be organized into appropriate size pursuant to their function and respective complexity. As a rule, every civil servant or administrative - technical and support staff is part of an administrative unit.</p> | <p>2. Regulatorna agencija se osniva zakonom.</p> <p>3. Stavovi 3. i 4. člana 12 ovog Zakona se primenjuju i na regulatorne agencije.</p> <p style="text-align: center;"><u>Potpoglavlje 3</u></p> <p style="text-align: center;"><u>Unutrašnja organizacija državne uprave</u></p> <p style="text-align: center;">Član 15 Unutrašnja organizacija ministarstva</p> <p>1. Ministarstvom upravlja ministar i organizovano je prema sledećim hijerarhijskim nivoima:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. generalni sekretar;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. odeljenja i</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. odseci.</p> <p>2. Upravne jedinice navedene u tačkama 1.2. i 1.3 stava 1 ovog člana se organizuju u odgovarajućem obimu, u skladu sa njihovom funkcijom i složenošću odgovarajućih zadataka. Po pravilu, svaki civilni službenik ili administrativno-tehnički službenik i službenik za podršku je deo jedne upravne jedinice.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>3. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për organizimin e Zyrës së Kryeministrit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Zëvendësministri</p> <p>1. Çdo ministër mund të mbështetet nga zëvendësministri/at.</p> <p>2. Zëvendësministri/at ndihmojnë ministrin dhe janë pjesë e hierarkisë administrative vetëm kur e zëvendësojnë ministrin në rastet e mungesës së tij të përkohshme apo për përgjegjësitë e deleguara shprehimisht nga ministri.</p> | <p>3. Provisions of this law are also applied, as appropriate, for the organization of Office of Prime Minister, unless otherwise provided for in a special law.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Deputy Minister</p> <p>1. Each minister may be supported by a deputy minister/deputy ministers.</p> <p>2. Deputy minister/s assist the minister and are part of administrative hierarchy only when substituting the minister in cases of temporary absence or for responsibilities delegated explicitly by the minister.</p> | <p>3. Odredbe ovog člana primenjuju se mutatis mutandis i na organizaciju Kancelarije premijera, osim ukoliko nije drugačije određeno posebnim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Zamenik ministra</p> <p>1. Svaki ministar može imati podršku jednog ili više zamenika ministra.</p> <p>2. Zamenici ministara pomažu ministru i deo su upravne hijerarhije samo kada zamenjuju ministra u slučaju privremenog odsustva ili kada obavljaju odgovornosti koje im je ministar izričito delegirao.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 17 Kabineti ministror</p> <p>1. Ministri dhe zëvendësministri/at mbështeten nga një kabinet i përbashkët ministror. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Nëpunësit e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi personelin e sistemit ministror.</p> | <p style="text-align: center;">Article 17 Ministerial cabinet</p> <p>1. Minister and deputy minister/s are supported by a joint ministerial cabinet. Cabinet is not part of the hierarchical structure of the ministry. Cabinet employees do not exercise any managerial or administrative competences over the staff of the ministerial system.</p> | <p style="text-align: center;">Član 17 Kabinet ministarstva</p> <p>Ministra i zamenika ministra podržava zajednički ministarski kabinet. Kabinet nije deo hijerarhijske strukture ministarstva. Službenici kabineta nemaju nikakvu upravljačku ili upravnu nadležnost nad osobljem ministarskog sistema.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 18 Sekretari i Përgjithshëm</p> <p>1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më</p> | <p style="text-align: center;">Article 18 General Secretary</p> <p>1. General Secretary is the highest civil servant</p> | <p style="text-align: center;">Član 18 Generalni sekretar</p> <p>1. Generalni sekretar je najviši civilni</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror.</p> <p>2. Sekretari i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e ministrit, në pajtim me ligjin.</p> <p>3. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore:</p> <p>3.1. mbështet ministrin në punën e tij;</p> <p>3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse;</p> <p>3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit;</p> <p>3.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror;</p> <p>3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura;</p> <p>3.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> | <p>of the ministry, responsible for directing the entire administrative and professional activity of the ministerial system.</p> <p>2. General Secretary reports and answers directly to the minister and performs his duty under the leadership and guidance of the minister according to the law.</p> <p>3. General Secretary has the following main responsibilities:</p> <p>3.1. supports the minister in his/her work</p> <p>3.2. ensures coordination of policy development in respective ministry;</p> <p>3.3. ensures implementation and control of implementation of legislation, policies and decisions of the minister;</p> <p>3.4. ensures management, coordination, control and supervision of the entire ministerial system,</p> <p>3.5. ensures cooperation with other ministries and institutions, and independent agencies;</p> <p>3.6. decides on administration of financial, material and human resources of ministerial system in accordance with the applicable legislation;</p> | <p>službenik ministarstva, odgovoran za upravljanje svim upravnim i profesionalnim aktivnostima ministarskog sistema.</p> <p>2. Generalni sekretar izveštava i odgovara direktno ministru i obavlja svoje dužnosti pod rukovodstvom i prema uputstvima ministra, u skladu sa zakonom.</p> <p>3. Generalni sekretar ima sledeće glavne odgovornosti:</p> <p>3.1. podržava ministra u svom radu;</p> <p>3.2. obezbeđuje koordinaciju razvoja politika u odgovarajućem ministarstvu;</p> <p>3.3. obezbeđuje sprovođenje i kontrolu sprovođenja zakonodavstva, politika i odluka ministra;</p> <p>3.4. obezbeđuje upravljanje, koordinaciju, kontrolu i nadzor celokupnog ministarskog sistema;</p> <p>3.5. obezbeđuje saradnju sa drugim ministarstvima i institucijama, kao i sa nezavisnim agencijama;</p> <p>3.6. odlučuje o upravljanju finansijskim, materijalnim i ljudskim resursima ministarskog sistema, u skladu sa zakonodavstvom na snazi;</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri.</p> <p>4. Sekretari i Përgjithshëm mbështetet nga stafi profesional dhe mbështetës.</p> <p>5. Sekretari i Përgjithshëm, në rast mungese, zëvendësohet nga drejtori i një prej departamenteve të ministrisë, i caktuar me shkrim nga vetë Sekretari. Në rast paafësie afatshkurtër apo pamundësie shëndetësore, drejtori i departamentit që zëvendëson Sekretarin e Përgjithshëm caktohet me shkrim nga ministri.</p> <p>6. Sekretari i Përgjithshëm mund t’u delegojë detyrat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni drejtuesve të departamenteve apo divizioneve të ministrisë . Në këtë rast, ai mbetet përgjegjës për mbikëqyrjen e detyrave të deleguara.</p> <p>7. Sekretari i Përgjithshëm krijon një regjistër, në të cilin përcaktohen aktet e delegimit, detyrat dhe fusha e delegimit, personit të cilit i është deleguar dhe periudha e delegimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Departamenti</p> <p>1. Departamenti përfshin së paku dy divizione</p> | <p>3.7. any other responsibility provided in the law of delegated explicitly by the minister.</p> <p>4. General Secretary is supported by the professional and support staff.</p> <p>5. General Secretary, in case of absence, is substituted by the director of one of the departments of that ministry assigned in written form by the Secretary. In case of short term incapacitation or inability due to health, direct of the department substituting the general secretary is assigned in written by the minister.</p> <p>6. General Secretary may delegate the assigned tasks under paragraph 3 of this article to heads of administrative departments or divisions of the ministry. In that case, he/she remains responsible for supervision of delegated tasks.</p> <p>7. General Secretary creates a register which defines the delegation acts, tasks and areas of delegation, person to whom they are delegated and period of delegation.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Department</p> <p>1. A department shall consist of at least two</p> | <p>37.bilo koje druge odgovornosti određene zakonom ili koje je ministar izričito delegirao.</p> <p>4. Generalnog sekretara podržava profesionalno i pomoćno osoblje.</p> <p>5. U slučaju odsustva, generalnog sekretara zamenjuje direktor jednog od odeljenja ministarstva kojeg imenuje sekretar lično u pisanoj formi. U slučaju kratkoročne zdravstvene nesposobnosti direktora odeljenja koji menja generalnog sekretara određuje ministar u pisanoj formi.</p> <p>6. Generalni sekretar može preneti zadatke iz stava 3 ovog člana rukovodiocima upravnih odeljenja ili odseka ministarstva. U tom slučaju, ostaje odgovoran za nadgledanje prenetih zadataka.</p> <p>7. Generalni sekretar uspostavlja registar u koji se unose akti o delegiranju, dužnosti i oblasti delegiranja, lice koje je delegirano, kao i period delegiranja.</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Odeljenje</p> <p>1.Odeljenje obuhvata najmanje dva odseka sa</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>me funksione të ndërlidhura.</p> <p>2. Departamenti drejtohet nga drejtori i departamentit, i cili i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm.</p> <p>3. Drejtori i departamentit është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të divizioneve përbërëse, monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre.</p> <p>4. Drejtori i departamentit, në rast të mungesës, zëvendësohet nga udhëheqësi i divizionit, i caktuar me shkrim nga vetë drejtori apo, në rast paaftësie afatshkurtër ose pamundësie shëndetësore, caktohet me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm.</p> | <p>divisions with interrelated functions.</p> <p>2. Department is managed by the director of department, who reports and answers to the General Secretary.</p> <p>3. The director of the department shall be responsible for setting objectives of subordinate divisions, monitoring their activities, and ensuring coordination between them.</p> <p>4. Director of department, in case of absence, is substituted by the head of division assigned in written by the director or in case of short term incapacitation or inability due to health is assigned by the General Secretary.</p> | <p>međusobno povezanim funkcijama.</p> <p>2. Odeljenjem rukovodi direktor odeljenja koji podnosi izveštaje i odgovara generalnom sekretaru.</p> <p>3. Direktor odeljenja je odgovoran za definisanje ciljeva podređenih odseka, praćenje njihovih aktivnosti i obezbeđivanje koordinacije između njih.</p> <p>4. Direktora odeljenja, u slučaju odsustva, menja šef odseka kojeg imenuje direktor lično u pisanoj formi, a u slučaju njegove kratkoročne zdravstvene nesposobnosti određuje ga generalni sekretar.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 20 Divizioni</p> <p>1.Divizioni është struktura themelore e organizimit të një ministrie dhe është ekskluzivisht përgjegjës për fushën e caktuar të përgjegjësisë brenda ministrisë.</p> <p>2. Divizioni udhëhiqet nga udhëheqësi i divizionit. Përveçse kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, udhëheqësi i divizionit i raporton drejtpërdrejt drejtorit të departamentit, pjesë e të cilit është divizioni.</p> <p>3. Udhëheqësi i divizionit, në rast të</p> | <p style="text-align: center;">Article 20 Division</p> <p>1. A division is the basic structure of organization of a ministry and shall be exclusively responsible for a certain area of responsibility within the ministry.</p> <p>2. Division is managed by the head of division. Unless otherwise provided in this law, head of division reports directly to the director of department, to which the division belongs to.</p> <p>3. In case of absence the head of division may</p> | <p style="text-align: center;">Član 20 Odsek</p> <p>1. Odsek je osnovna organizaciona struktura ministarstva i isključivo je nadležan za određenu oblast odgovornosti unutar ministarstva.</p> <p>2. Odsekom rukovodi šef odseka. Osim ukoliko je drugačije određeno ovim zakonom, šef odseka direktno odgovara direktoru odeljenja čiji je odsek deo.</p> <p>3. Šefa odseka, u slučaju odsustva,</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>mungesës, zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë i të njëjtit divizion. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë, që ka përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil. Në rast të paaftësisë afatshkurtër dhe pamundësie shëndetësore të udhëheqësit të divizionit, zëvendësimi caktohet nga drejtori i departamentit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Organizimi i strukturave përgjegjëse për funksionet e brendshme administrative të ministrisë</p> <p>1. Shërbimet e teknologjisë së informacionit, mirëmbajtja, logjistika dhe shërbimet e tjera të ngjashme (në vijim : shërbimi i menaxhimit të përgjithshëm) kryhen të gjitha së bashku nga një njësi administrative, që i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm.</p> <p>2. Shërbimet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar (në vijim: shërbimi i menaxhimit financiar) kryhen të gjitha së bashku nga një njësi administrative, që i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm. Udhëheqësi i kësaj njësie është njëkohësisht zyrtar kryesor financiar, i cili menaxhon financat publike në përputhje me ligjin.</p> <p>3. Funksionet e auditimit të brendshëm kryhen</p> | <p>be substituted by a most senior level civil servant of the same division. Should there be more than one civil servant at the same level, he shall be substituted by highest level civil servant with longest experience in the Civil Service. In case of short term incapacity or inability due to health of head of division, the substitute will be assigned by the director of department</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Organization of responsible structures for internal administrative functions of the ministry</p> <p>1. Information technology services, maintenance, logistics and other similar support services (hereinafter “general management service”) shall be performed together by one administrative unit, which reports directly the General Secretary.</p> <p>2. Services related to financial planning, implementation, accounting and reporting (hereinafter: “financial management service”) shall be exercised by an administrative unit, which reports directly to the General Secretary. Head of this unit is at the same time Chief Financial Officer in accordance with legislation on public financial management.</p> <p>3. Functions of internal audit shall be exercised</p> | <p>zamenjuje javni službenik najvišeg nivoa u tom odseku. ukoliko postoji više civilnih službenika istog nivoa, zamenjuje ga najviši civilni službenik koji ima najduže iskustvo u civilnoj službi. U slučaju kratkoročne zdravstvene nesposobnosti šefa odseka direktor odeljenja određuje zamenika.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Organizacija struktura odgovornih za unutrašnje upravne funkcije ministarstva</p> <p>1. Usluge informacionih tehnologija, održavanje, logistiku i druge srodne usluge podrške (u daljem tekstu: „opšte upravne usluge“) obavlja zajedno jedna upravna jedinica koja direktno podnosi izveštaje generalnom sekretaru.</p> <p>2. Funkcije vezane za finansijsko planiranje, sprovođenje, računovodstvo i finansijsko izveštavanje (u daljem tekstu: „funkcije finansijskog upravljanja“) obavlja jedna upravna jedinica koja podnosi izveštaje direktno generalnom sekretaru. Šef ove jedinice je istovremeno i glavni finansijski službenik, u skladu sa zakonodavstvom o upravljanju javnim finansijama.</p> <p>3. Funkcije unutrašnje revizije obavlja</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>nga një njësi administrative, që i raporton ministrit.</p> <p>4. Njësitë e parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni organizohen si departament apo divizion, në varësi të madhësisë dhe kompleksit të detyrave përkatëse.</p> <p>5. Kriteret për organizimin e funksioneve si në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni rregullohen me akt nënligjor në pajtim me këtë ligj dhe ligjet e veçanta, propozuar nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe të aprovuar nga Qeveria.</p> | <p>by an administrative unit directly reporting to the minister.</p> <p>4. Units as provided by paragraphs 1, 2 and 3 of this Article shall be organized as departments or divisions, depending on the size and complexity of relevant duties.</p> <p>5. Criteria for the organisation of functions under paragraph 1, 2, 3 and 4 of this article are regulated with a bylaw in accordance with this law and special laws, proposed by the responsible ministry for public administration and approved by the Government.</p> | <p>upravna jedinica koja direktno podnosi izveštaje generalnom sekretaru.</p> <p>4. Jedinice navedene u stavovima 1, 2. i 3. ovog člana su organizovane kao odeljenja ili odseci, u zavisnosti od obima i složenosti relevantnih zadataka.</p> <p>5. Kriterijumi za organizaciju funkcija iz stavova 1, 2, 3. i 4. ovog člana uređuju se podzakonskim aktom u skladu sa ovim Zakonom i posebnim zakonima koje predlaže ministarstvo nadležno za javnu upravu i usvaja Vlada.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 22 Drejtimi i Agjencisë Ekzekutive</p> <p>1. Agjencia Ekzekutive drejtohet nga drejtori ekzekutiv.</p> <p>2. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë.</p> <p>3. Drejtori ekzekutiv për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të sistemit ministror.</p> <p>4. Në rastet e agjencive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, në ligjin e themelimit</p> | <p style="text-align: center;">Article 22 Management of Executive Agency</p> <p>1. Executive Agency is headed by the executive director.</p> <p>2. Executive director of the Agency is a civil servant of senior managerial category according to the Law on Public Officials.</p> <p>3. On the performance and activity of the agency the executive director answers to the minister, through the General Secretary of ministerial system.</p> <p>4. In cases of larger agencies with complex activity, the law of establishment of agency</p> | <p style="text-align: center;">Član 22 Upravljanje izvršnom agencijom</p> <p>1. Izvršnom agencijom upravlja izvršni direktor.</p> <p>2. Izvršni direktor Agencije je javni službenik više rukovodilačke kategorije, u skladu sa Zakonom o javnim službenicima.</p> <p>3. Izvršni direktor, za rad i učinak Agencije, odgovara ministru preko generalnog sekretara ministarskog sistema.</p> <p>4. U slučaju velikih agencija sa složenom aktivnošću, zakonom o osnivanju agencije</p> |

| | | |
|---|---|--|
